

Tasim  
Gjokutaj



BISEDE  
ME  
MBESEN

poema



814-98-1  
BPL.

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

Rezervuar  
GJENIOS GJRTI

Tasim  
Gjokutaj

Bisedë  
me  
mbesën



POEMA

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

Bisedë  
me  
mbesën

1.

Unë s'kam qenë gjithnjë gjyshe,  
flokëbardhë me syze në sy,  
moj mbesëz, kam qenë dhe ndryshe,  
e vogël, e vogël sa ti.

Kam pasur ca shoqe në fshat,  
si shoqet e tua, të mira,  
gëzime dhe bukë kishim pak,  
po kishim një mal me dëshira.

Dhe kukullat i donim, i donim,  
po s'patëm një kukull, të shkretën,  
me lecka e pecka sajonim  
ca kukulla të varfra si veten...

Kam pasur një shoqe, moj Edë,  
Burbuqen, të bukur si nuri,  
me sytë të kaltër si deti,  
me flokët të artë si gruri.



Me çapin të lehtë, thëllëzë,  
oh, lëre se ç'vajzë që ishte,  
s'arriti ditëzeza të bëhej  
as nuse, as nënë, as gjyshe.

Si iku? As unë s'e kuptova,  
dy ditë në lojë pat' munguar;  
ndaj shkova me vrap e kërkova,  
më thanë: «Te halla ka shkuar!»

Më thanë: «Te halla ka shkuar,  
në fshatin pesë male kaptuar...»  
E prita në lëmë te ledhi  
një ditë, dy ditë... po s'erdhë.

Malli më piku, letra, nuk bënim,  
se shkronjat, moj mbesë, s'i dinim,  
ndaj dilja çdo mbrëmje te lëmi  
të pyesja gjith' zogjtë që vinin.

Ata s'më tregonin asgjë  
Ç'u bë ajo vajzë, ç'u bë?

2.

Kur oxhakët villnin tym  
mbi kasolle, si çibukë,  
dhe dëbora me thëllim  
mbuloi fshatin pup e pup!

erdh' një lajm i zi si nata,  
që të gjithë i mallëngjeu:  
«Burbuqen me flokë të arta,  
thonë... lumi e rrëmbeu».

Kur e thanë atë emër,  
qysh u mbajta, nuk e di,  
si një thikë e fortë në zemër  
më goditi lajmi i zi.

Mora rrugën për në lumë,  
lumi rridhte tatëpjetë,  
thihhte borë e nxirrte shkumë  
dhe nxitonte për në det...

«Ndal, o lumë, ndal, moj borë!  
Ndal, pa ndal dhe ti, moj erë!  
Shoqen time, kush e mbyti?  
Hë pra, flisni, po ju them!»

Lumi rend me vrap si kalë,  
bora bie pa pushim,  
ndërsa era nëpër mal  
ulurin e ulurin...

3. Një djalë nga fshati  
lajm tjetër përhapi:  
«Vajzën e filanit  
nuk e mbyti lumi,  
e mbyti... Kanuni!»

Një djalë nga fshati  
lajm tjetër përhapi:  
«Vajzën e filanit  
nuk e mbyti lumi,  
e mbyti... Kanuni!»

Kanuni s'qe lumë,  
as pushkë, as litar,  
Kanuni qe libër  
i ngopur me fjalë.

Ti, Eda, ke sot  
plot libra të bukura  
me yje, me zogj,  
me trena, me flutura.

Si librat e tua  
Kanuni nuk ishte,  
ai brenda kishte  
ligje të çuditshme:

